

Numri i Dokumentit	DL	Në fillim	18/1/22
Numri i Dokumentit	1	Data	14/1/22
RISHTIMET			



Numri i Dokumentit	06/401	Data	23/24/1/2022
Numri i Dokumentit		Data	13/01/2022

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
 Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti i Buxhetit - Departman budžeta - Budget Department

DATË	12.01.2022
REFERENCË	M-006/2022
PËR/ZA/TO:	znj. Kujtesa Haliti, Zyrtare ligjore, Divizioni për Hartim dhe Harmonizim, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
CC:	z. Izedin Bytyqi, Zëvendësues Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës znj. Florije Kika, Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës znj. Vlora Osaj, Udhëheqëse e Divizionit për Hartim dhe Harmonizim, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve
NGA/OD/FROM:	Remzi Sylejmani, Zv. Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinionimi i Departamentit të Buxhetit për vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes

E nderuara znj. Haliti,

Bazuar në kërkesën për vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, të paraqitur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (në vijim MMPHI-ja), formularin e vlerësimit të ndikimit buxhetor të përgatitur nga MMPHI-ja, obligimin sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, dhe nenin 18 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.

Departamenti i Buxhetit paraqet me sa vijon:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME

Ky projektligj ka për qëllim të përcaktoj kompetencat dhe përgjegjësit institucionale dhe caktimin e rregullave në parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes nga veprimtaritë e ndryshme industriale në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë për mbrojtjen e mjedisit.

OPINIONI PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR (VNB) TË PROJEKTLIGJIT NGA MINISTRIA PROPOZUESE

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - si organ propozues, ka përgatitur vlerësimin e ndikimit buxhetor të këtij projektligji dhe e ka paraqitur përmes formularit të vlerësimit të ndikimit buxhetor, sipas të cilit vlerësohet dhe planifikohet se ky projektligj për t'u zbatuar kushton 209,876 € për periudhën 2022-2024 e shpërndarë nëpër vite dhe kategori të shpenzimeve si vijon:

VITET	2022	2023	2024	Totali
Paga dhe Shtesa	63,839	64,158	64,479	192,476
Mallra dhe Shërbime	5,800	5,800	5,800	17,400
Totali	69,639	69,958	70,279	209,876

Ky projektligj do të zbatohet në praktik nga zyrtarët të punësuar në Departamentin e Mjedisit, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit, Institutin e Planifikimit Hapësinor, Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës të cilët funksionojnë në kuadër të MMPHI-së.

Ndër aktivitetet kryesore të këtij projektligji janë:

- Hartimi i legjislacionit;
- Kontrolli i integruar i ndotjes industriale;
- Lëshimi i lejeve të integruara,
- Mbikëqyrja inspektuese.

PËRFUNDIM:

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit vlerëson se Projektligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes nga aspekti i ndikimit buxhetor nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, duke nën kuptuar se të gjitha aktivitetet të cilat dalin nga ky projektligj do të zbatohen nga ndarjet buxhetore të planifikuara me Ligjin me Nr.08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 si dhe vlerësimeve për vitet 2023-2024 për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Përgatitur nga:

Fëllanza Mekuli, Analiste e lartë e buxhetit

Konfirmoi:

Milaim Aliu, Udhëheqës i divizionit të buxhetit qendror